



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES**

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

MARS 2008

Mesazhi i Ministrit



Samiti i Bukureshtit dhe marrja e ftesës për anëtarësim në Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO) përbën një ngjarje të madhe për Shqipërinë. Me përgjegjshmërinë e kësaj ngjarjeje historike, veprimtaritë kryesore të Forcave të Armatosura gjatë vitit 2008 do të përqendrohen në realizimin e objektivave të zhvillimit të një force ushtarake të aftë për të merituar anëtarësimin e plotë në samitin e ardhshëm.

Gjatë vitit që shkoi, FA zhvilluan një proces të gjerë transformimi e reformash që lidhen me zbatimin e objektivave të marra nga Qeveria Shqiptare në fushën e mbrojtjes, duke synuar hartimin e planeve dhe programeve konkrete për arritjen dhe përmbushjen e tyre mbështetur në Planin e Integruar të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2007. Shqipëria demonstroi progres të vlerësuar në reformat politike, ekonomike, ushtarake, ligjore, e të mbështetjes me resurse. Rritja e kontributeve në operacionet paqeruajtëse është shprehje e qartë se NATO-n e shikojmë si një familje ku do të japim kontributin tonë për sigurinë dhe stabilitetin.

Për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të sotme e të ardhme të sigurisë Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura edhe gjatë vitit 2008 do të vazhdojnë në rrugën e reformave të cilat do të synojnë një forcë të vogël në numër, por profesioniste, të stërvitur e të pajisur shumë mirë, të aftë për përmbushjen e misionit kushtetues dhe të kontribuojë në forcimin e sigurisë e paqes globale. Duke planifikuar me kujdes burimet financiare të siguruara nga buxheti i mbrojtjes, do të synohet : modernizimi i mëtejshëm i Forcave të Armatosura sipas një programi të konsoliduar për arritjen e standardeve të NATO-s, rritja e nivelit operacional, dislokueshmërisë, veçanërisht të strukturave të përcaktuara si prioritare të angazhuara në misione në Operacionet/Misionet e drejtuara nga NATO/BE/OKB dhe Koalicioni Botëror Kundër Terrorizmit.

Plani i Integruar i Ministrisë për vitin 2008 përbën një dokument të rëndësishëm te i cili strukturat e Forcave tona të Armatosura duhet të mbështeten në përmbushjen e këtyre prioriteteve. Zbatimi me sukses i këtij plani kërkon përmirësimin e aftësive të menaxhimit të strukturave tona të komandimit dhe stafeve, për të plotësuar standardet e NATO-s, bazuar në mësimet e nxjerra gjatë vitit 2007, e të shoqëruara me artikullimin nga strukturat përkatëse të objektivave konkrete për vitin 2008, në afate, me përgjegjësi konkrete e të mbështetura me burimet e nevojshme.

Është në dorën tonë ta bëjmë atë të frytshëm përmes realizimeve që kompozojnë performancën e nevojitur për të merituar anëtarësimin në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Tani është koha për të realizuar përgjegjësitë tona, angazhimin tonë në shërbim të Atdheut, Nderit dhe Detyrës.

Ju faleminderit!

Gazmend Oketa
Ministër i Mbrojtjes



Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	7
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	8
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	12
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur.....	13
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	14
Aneks 3	Investimet Publike	15
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	17
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	19

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Mbrojtjes ka për mision ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Politikën e Mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e vendit.

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse përpara Presidentit të Republikës, Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave për zbatimin e misionit kushtetues për mbrojtjen e vendit duke zbatuar funksionet e mëposhtme:

Përfaqësimin në organet e lartpërmendura dhe në Këshillin e Sigurimit Kombëtar duke dhënë mendim të specializuar për problemet e mbrojtjes, zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe integritit në NATO

Pasqyrimin në programin e zhvillimit perspektiv të FA, të politikave dhe direktivave të qeverisë në fushën e mbrojtjes, në fushën sociale, në atë të integritit, zhvillimit e modernizimit të FA në nivelin e kërkesave të kohës

Sigurimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me bazë mirëbesimi në fushën ushtarake, ndërmjet shteteve.

Ndërtimin e politikave dhe praktikave që favorizojnë bashkëpunimin, përcaktimin e prioriteteve dhe synimeve, të cilat krijojnë hapësira bashkëpunimi në interes të rritjes së sigurisë kolektive dhe plotësimin e interesave të vendit

Ndërtimin e politikave të përshtatshme arsimimi për të gjithë personelin e FA duke synuar shkallë të lartë motivimi

Standardizim të veprimtarisë së brendshme në FA dhe integrim normal në shoqëri

Sigurimin e mbarëvajtjes së brendshme në FA në përputhje me zhvillimet e tjera shoqërore duke siguruar menaxhim optimal të burimeve njerëzore, financiare e materiale, me qëllim që zhvillimi e modernizimi i FA të jetë kurdoherë e në çdo rrethanë në përputhje me zhvillimet politike e ushtarake në rajon e më gjerë

Hartimin e programeve të bashkëpunimit me të gjitha institucionet e tjera shtetërore në funksion të angazhimeve të tyre ligjore për zbatimin e kërkesave të Strategjisë së Sigurimit dhe Politikës së Mbrojtjes, si për mbrojtjen e vendit ashtu edhe për përballimin e fatkeqësive natyrore

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e mbrojtjes

Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Mbrojtjes 2007-2013 është miratuar me VKM Nr.763, datë 14.11.2007. Ajo ka për qëllim të japë drejtimet kryesore të zhvillimit e të transformimit të FA për vitet e ardhshëm, të përcaktojë objektivat që do të arrihen në periudhën afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe të orientojë zhvillimin e kapaciteteve operacionale të nevojshme për përmbushjen e misioneve kombëtare dhe të kërkesave të integritimit në NATO. Kjo strategji synon të zhvillojë një koncept të integruar dhe të orientojë hartimin dhe zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse me efekte sinergjike të përdorimit të gjithë komponentëve përbërës të fuqisë luftarake të Forcave të Armatosura.

Qëllimet

Politika e Sektorit Mbrojtje mbështetet në qëllimet e mëposhtme afatgjata:

- Arritja e standardeve të punës dhe aktiviteteve të krahasueshme me ato të NATO-s, duke bërë të mundur transformimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në një forcë të mirëpërgatitur, të mirëpajisur me kapacitetet e nevojshme dhe të afta për të marrë pjesë në misionet dhe detyrat e ngarkuara brenda dhe jashtë vendit.
- Zhvillimi dhe siguri i kapaciteteve dhe aftësive vepruese operacionale të strukturave ushtarake të Forcave të Luftimit për të mundur realizimin në kohë të detyrave ushtarake për mbrojtjen e vendit nga kërcënime dhe reziqe të mundshme, realizimin e detyrave për operacione humanitare në rast fatkeqësish natyrore/njerëzore brenda vendit dhe për sigurimin e plotësisht të detyrimeve të integritimit Euro-Atlantik e kontributeve në operacionet aktuale dhe ato të mundshme të ardhshme paqeruajtëse jashtë vendit.
- Mbështetja e procesit të transformimit të FA për realizimin e një force në rritjen e operacjonalitetit në zbulim, rikonicion, transport trupash, komunikim, siguri trupash, shërbime të ndryshme, një forcë e stërvitur mirë për të siguruar dhe përmbushur misionet e saj dhe standartet në NATO.
- Siguri i Mbështetjes së operacioneve të ndryshme luftarake dhe jo luftarake të strukturave të FA përmes garantimit të kompletimit me personel, mirëpajisjes dhe mbështetjes me infrastrukturë e shërbime. Siguri i efikasitetit të investimeve të fokusuara në modernizimin e sistemeve dhe paisjeve. Mbështetja e synimit për një forcë të vogël dhe shumë efikente. Garantimi i mbështetjes së strukturave të FA për plotësimin e objektivave sipas afateve që garantojnë kriteret për pranimin në strukturat e aleancës së NATO-s.
- Përgatitje e mjedisit për mbështetje politike, shoqërore, ekonomike, financiare, njerëzore dhe infrastrukturore të veprimtarisë operacionale të Forcave të Armatosura.
- Planifikimi dhe koordinimi i veprimtarisë së FA në përputhje me ligjin, mundësitë dhe kapacitetet, me strukturat shtetërore ose vullnetare për përballimin e emergjencave civile në mbrojtje të popullsisë, ekonomisë, mjedisit e pasurisë.
- Siguri i mbështetjes së domosdoshme ndaj autoriteteve civile për shërbimet publike dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për vendosjen e rendit kushtetues.
- Përgatitja, zhvillimi dhe zbatimi i projekteve, planeve e programeve dhe koncepteve doktrinale të stërvitjes dhe të arsimimit ushtarak për të formuar e zhvilluar një forcë ushtarake të mirarsimuar, të ndërveprueshme me strukturat e NATO-s.
- Parandalimi i sëmundjeve dhe epidemive.
- Rraftësimi i forcave në kohë paqeje, konflikti dhe krize.
- Rritja e standardeve të kërkuara në fushën e shërbimit shëndetësor ushtarak për anëtarësimin në strukturat euroatlantike.
- Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve ushtarakë nëpërmjet përmirësimit të diagnostikimit dhe trajtimit spitalor.

- Mbështetja financiare pas daljes në lirim të ish-ushtarakeve deri në integrimin e tyre në ekonominë e tregut.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin e mbështetjes me burimet financiare dhe materiale, infrastrukturën e duhur, kushtet normale për punë e aktivitet të stafëve të MM, SHPFA, Komandave të Forcave, formacioneve dhe përfaqësuesve të Forcave të Armatosura Shqiptare në interes të realizimit të misioneve dhe detyrave të ngarkuara brenda dhe jashtë vendit.

3.2 FORCAT E LUFTIMIT

Politika e këtij programi konsiston në realizimin në kohë të detyrave ushtarake për mbrojtjen e vendit nga kërcënime dhe rreziqe të mundshme, realizimin e detyrave për operacione humanitare në rast fatkeqesish natyrore/njerëzore brenda vendit dhe sigurimi i plotësisht të detyrimeve të integritetit Euro-Atlantik dhe kontributeve në operacionet aktuale dhe ato të mundshme të ardhshme paqeruajtëse jashtë vendit.

3.3 MBËSHTETJA E LUFTIMIT

Politika e këtij programi konsiston në rritjen e treguesve të operacionalitetit të formacioneve të mbështetjes së luftimit, duke siguruar kapacitetet e nevojshme në realizimin e misioneve dhe detyrave të formacioneve të luftimit në operacionet luftarake dhe humanitare brenda dhe jashtë vendit.

3.4 MBËSHTETJA E PËRQENDRUAR

Politika e këtij programi konsiston në menaxhimin e zinxhirit të operacioneve logjistike në mbështetje të njëjësive në operacione luftarake dhe jo luftarake brenda dhe jashtë vendit. Menaxhimin e burimeve në funksion të mbështetjes së krijimit dhe konsolidimit të kapaciteteve të plota me personel, infrastrukturë, furnizime dhe shërbime për të gjitha llojet e operacioneve ku strukturat e Forcave të Armatosura do të marrin pjesë. Krijimin dhe rritjen e efikasitetit të strukturave si Qendrat e Menaxhimit të Personelit dhe Rekrutimit si dhe Zhvillimit të Sistemeve, mbështetjes së programeve të tyre gjatë vitit 2008 e në vazhdim.

3.5 BASHKËPUNIMI CIVILO - USHTARAK (AL - CIMIC)

Politika e këtij programi konsiston në mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura në të gjitha nivelet e drejtimit, nëpërmjet planizimit, bashkëpunimit dhe koordinimit të marrëdhënieve me strukturat qeverisëse, popullsinë, organizatat joqeveritare, subjekte e agjensi të ndryshme vendore, kombëtare e ndërkombëtare në hapësirën operacionale të veprimit.

3.6 ARSIMI USHTARAK

Politika e këtij programi konsiston në organizimin, zhvillimin, drejtimin dhe realizimin e përgatitjes, arsimimit e kualifikimit të oficerëve, nënoficerëve e drejtuesve të Forcave të Armatosura, zhvillimin e koncepteve doktrinale të organizimit e përdorimit të Forcave të Armatosura dhe i koncepteve e programeve të arsimimit dhe të stërvitjes; përpunimi e zbatimi i standardeve e kërkesave për stërvitjen në funksion të rritjes së aftësive të Forcave të Armatosura, në përmbushje të misionit dhe standardeve të NATO.

3.7 MBËSHTETJA SHËNDETËSORE

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin e mbështetjes mjekësore cilësore, parësore dhe të specializuar, për efektivat e FA brenda dhe jashtë vendit, për familjarët e tyre, për ushtarakët e huaj me mision në vendin tonë, personeli i Ministrisë së Brendshme (police dhe ushtarake), si dhe mbështetja e komunitetit civil për trajtimin e politraumës.

3.8 MBESHTETJE SOCIALE PËR USHTARAKET

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin dhe mbështetjen financiare të ushtarakëve në rezervë, lirim e pension në zbatim të ligjit

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme gjatë vitit 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Të vazhdojë zbatimin e projekteve të programuara dhe të sigurohet mbështetja me burime financiare për modernizimin në vazhdimësi të infrastrukturës së nevojshme për punë dhe aktivitet të stafeve të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, dhe misioneve të FA jashtë vendit dhe rritja e pjesëmarrjes në shtabet e partneritetit me NATO/n.
- Përmirësimi strukturor mbështetur në përvojën e vitit 2007.
- Konsolidimi i strukturës të KFB.
- Konsolidimi i Komandës Mbështetëse në mbështetjen e strukturave të FA.

Produktet që do të ofrohen:

- Rikonstrukcion i një objekti në Ministrinë e Mbrojtjes.
- Funksionimi i sistemit të Planifikimit Administrimit.
- Rikonstrukcion i Komandës së Forcës së Bashkuar.

4.2 FORCAT E LUFTIMIT

Objektivat e politikës:

- Krijimin e kapaciteteve të integruara të komandimit, kontrollit, komunikimit, kompjuterizimit dhe të informacionit (C4-I).
- Për BrRSH mbajtja e nivelit k1 në b2k. Arritja e nivelit k2 me b3k, k3 me elementet e tjerë, mbajtja e nivelit k4 për batalionin e artilerisë.
- Mbajtja e nivelit k2 në Regjimentin Komando.
- Arritja e nivelit k3 në Regjimentin e Helikopterëve (futja e 1 helikopteri BO 105 dhe 2 helikopteri AB 205).
- Arritja e nivelit k4 në Batalionin e Mbrojtjes Ajrore.
- Brigada Detare; Arritja e nivelit operacional k3, blerja e një anije patrulluese të madhe.
- Për 2 Flotiljet Detare arritje e nivelit k3 si dhe blerja e një anije patrulluese të madhe.
- Vazhdimi i kontributit në operacionet paqeruajtëse në Irak dhe në Bosnje Hercegovinë, rritja e angazhimit në Afganistan nga një togë në një kompani, plotësimi i të gjitha detyrimeve të tjera të integritit.

Produktet që do të ofrohen

- Planizimi për shtimin e mundshëm të pjesëmarrjes së FA në operacionet e drejtuara nga NATO, BE, OKB ose Koalicioni i Vullnetit; në operacionin ISAF në Afganistan me dy ekipe OMLT; një ekip EOD në misionin Althea të EUFOR; një kontribut për pjesëmarrje në misionin e BE në Çad, përfaqësime të mundshme në misione të OKB; shtimin e mundshëm të kontingjentit në misionin "Iraqi Freedom", si dhe pjesëmarrjen në operacionin e NATO-s "Active Endeavor" në Mesdhe.
- Katër objekte të ndërtruara dhe rindërtuara: rikonstrukcion i rrjetit të ujës-jellës dhe fibrave optike në Pashaliman; rikonstrukcion i objektit në funksion të SIVHD në Brigadën Detare; ndërtim linje elektrike në Zall-Herr; ndërtim kabine elektrike në Zall-Herr.

4.3 MBËSHTETJA E LUFTIMIT

Objektivat e politikës

- Ruajtja dhe rritja e kapaciteteve operacionale të reparteve të mbështetjes së luftimit.
- Mbështetja e njërive prioritare duke synuar zhvillimin e modernizimin e tyre.
- Mbështetja e programeve të modernizimit të FA me zbulim, transport trupash, komunikim, sigurim trupash dhe shërbime.

Produktet që do të ofrohen

- Funksionimi Brigadës Ajrore, Batalionit të Policisë Ushtarake dhe dy strukturave autonome të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Pajisje e sisteme speciale për Qendrën e radiozbulimit dhe pajisje për identifikimin e helikopterave.

4.4 MBËSHTETJA E PËRQENDRUAR

Objektivat e politikës

- Vënia në efikasitet sipas kapacitetit operacional K 4 të Brigadës logjistike dhe Grupi AEM në K2.
- Ndërtimi i Sistemeve të Integruara Logjistike dhe të menaxhimit të personelit. Ndërtimi i rrjeteve të integruar në të gjithë përdoruesit.

Produktet që do të ofrohen

- Përmirësimi i normave të trajtimit me ushqim të efektivave.
- Përmirësimi i normave të veshmbathjes.
- Zhvillimi i kazermimit.
- Përmirësimi i Infrastrukturës të qëndrimit, jetesës dhe mësimore; ndërtimi i ambienteve të reja dhe përshtatja e rikonstruksioni i atyre ekzistuese.
- Pajisje për modernizimin e F.A. si vazhdimi i projektit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, Pajisje Individuale të Ushtarit, mjete transporti e zjarrfikëse, etj. Mbështetja me kredi për apartamente banimi për ushtarakët aktive.

4.5 BASHKËPUNIMI CIVILO - USHTARAK (AL - CIMIC)

Objektivat e politikës

- Vënie në funksionim të strukturave operacionale të AL-CIMIC në përputhje me kërkesën e PG 3780II.
- Konsolidimi i strukturës së Brigadës së Mbështetjes Rajonale dhe kompletimi me mjete kritike sipas TOP të Kompanisë së parë (PFP).
- Grumbullimi dhe përgatitja e ekipit të specialisteve funksional të AL-CIMIC sipas kërkesës së PG 3780II.
- Institucionalizimi i bashkëpunimit me subjektet e ndryshme civile në zonat operative të strukturave ushtarake duke siguruar mbështetje të përshtatshme për komunitetin në shërbimet publike.

Produktet që do të ofrohen

- Funksionimi i 26 strukturave të Br.Mb.Rajonale, Strukturë në varësi të KFB.

- Objekt i rikonstruktuar.

4.6 ARSIMI USHTARAK

Objektivat e politikës

- Realizimi dhe mbështetja e procesit mësimor në institucionet arsimore dhe në shkollat e trupës, për kryerjen e kurseve të parashikuara në planin afatgjatë të zhvillimit të Forcës.
- Shtimi dhe përmirësimi i bazës mësimore didaktike dhe i rrjeteve të automatizimit.
- Mbështetja e arsimit dhe stërvitjes me botime doktrimore, manuale, tekste, etj.

Produktet që do të ofrohen

- 3 Objekte të ndërtuara dhe rikonstruktura për gatishmërinë dhe stërvitje.
- Përgatitja e 125 ushtarakëve në kurse afatgjatë dhe afatshkurtër.
- Blerje e 2 Pajisjeve.
- Funksionimi i Komandës dhe shtabit KDS.
- Funksionimi i Br.S.
- Funksionimi i UUS "Skënderbej".
- Funksionimi i shkollës së trupës.
- Objekte të ndërtuara dhe rikonstruktura: ndërtimi i sistemit të ngrohjes në KDS dhe rikonstrukcioni i mjediseve sportive në KDS.

4.7 MBËSHTETJA SHËNDETËSORE

Objektivat e politikës

Arritja e sigurimit të mbështetjes mjekësore për ushtarakët brenda dhe me mision jashtë vendit.

Rritja e cilësisë së shërbimit mjekësor spitalor nëpërmjet diagnostikimit dhe uljes së ditë-qëndrimit spitalor të pacienteve

Produktet që do të ofrohen

- 57, 000 Pacientë-ekzaminim dhe mjekim.
- Ndërtimi impiantit të djegies së mbeturinave spitalore.

4.8 MBËSHTETJE SOCIALE PËR USHTARAKËT

Objektivat e politikës

Sigurimi i trajtimit financiar të ushtarakëve në rezervë e lirim sipas ligjit për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakut dhe ligjeve/akteve të tjera për trajtime të veçanta.

Produktet që do të ofrohen

- 19420 ish ushtarakë aktive që përfitojnë sigurim suplementar.

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek

Programe	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Të tjera transferte korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzim e kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	637	533	5	23	269	1,467
Forcat e Luftimit	2,572	1,444	-	43	2,535	6,595
Arsimi Ushtarak	756	469	-	27	343	1,595
Mbështetje Shëndetësore	208	290	-	2	217	717
Mbështetja e Luftimit	1,080	894	-	40	392	2,405
Mbështetja e Përqendruar	1,915	1,436	-	36	2,048	5,435
Mbështetje Sociale për Ushtaraket	-	-	2,723	-	-	2,723
Bashkëpunim Civil - Ushtarak (AL-CIMIC)	483	145	-	19	67	714
Total	7,651	5,211	2,728	190	5,870	21,650

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Objekte te ndërtuara dhe rikonstruara që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës së personelit të FA	Numër/Objekte	15
Pajisje Luftarake Individuale që do t'i shërbejnë modernizimit të FA në kuadër të anëtarësimit në NATO	Leke/mil	651
Blerje zjarrfikëse që do të përmirësojnë përballimin e situatave të emergjencave civile	Leke/mil	635
Blerje anije patrulluese në kuadrin e bashkëpunimit të sigurisë kombëtare në vëzhgimin e hapësirës detare	Leke/mil	895
Arsimi Ushtarak	Numër/Persona	530
Misione rajonale me qëllim forcimin e bashkëpunimit për sigurinë rajonale	Numer/Misione	6
Pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse në mbështetje të luftës ndaj terrorizmit dhe sigurisë	Numër/Persona	300
Numri i ushtarëve të rekrutuar në FA në kuadrin e përmirësimit të sistemit të rekrutimit dhe përgatitjes së ushtarit profesionist	Numër/Persona	3 400

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

- Projektligj “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës së Lartë Aleate për Transformimin “Lidhur me masat mbështetëse të shtetit pritës për përmbushjen e operacioneve të NATO-s”.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8671, date 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Projektligj “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradën dhe karrierën ushtarake të FA të RSH”.
- Projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar.
- Projektvendim “Për procedurat e kryerjes së ekspertizës së mallrave ushtarakë, mallrave teknologjike me përdorim të dyfishtë”.
- Projektvendim “Për procedurat e liçensimit, zgjatjen e afateve të aplikimit dhe procedimin e mëtejshëm”.
- Projektvendimi “Për procedurat e dhënies së garancive dhe të kryerjes së kontrollit shtetëror në përmbushje të detyrimeve për përdorimin e mallit”.
- Projektvendimi “Për pagat e atasheve ushtarakë dhe ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s, përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s dhe ushtarakët shqiptarë që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare”.
- Projektvendim “Për përballimin e shpenzimeve të atasheve ushtarakë dhe ushtarakëve të Forcave Armatosura që shërbejnë në shtabet e NATO-s, përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, dhe ushtarakët shqiptarë që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare”.
- Projektvendim “Për disa shtesa e ndryshime ne Vendimin nr. 839 datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave ” Për pagat e ushtarakeve aktivë të FA të RSH”.
- Projektvendim ”Për miratimin e normave të ushqimit për ushtarakët e FA të RSH”.
- Projektvendim ” Për organizimin, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore që kanë interesa në det”.

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

- Përgatitja e Kontingjentit paqeruajtës për misionet e BE.
- Hartimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe PNUD, mbi bashkëpunimin në fushën e çminimit në Republikën e Shqipërisë.
- Asgjësim industrial i municioneve nga uzinat.
- Asgjësim municionesh me plasje nga AEM.

Aneks 3 Investimet Publike

Kjo listë aktuale është brenda kuotave të miratuara në Ligjin e buxhetit të vitit 2008 dhe sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Financave në zbatim të udhëzimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2008.

Nr.	Emer Programit dhe Institucionit	Vlera Milion leke	Emertimi i projektit
1	2	3	4
3	Planifikim, Manaxhimi dhe Administrimi	269	TOTALI
1	Komanda Forces Bashkuar	185	Rikonstrukcion komanda e shtebi KFB
2	Drejtoria Administrimit dhe Sherbimeve ne MM	63	Permiresim Infrast. ne MM
3		21	Pajisje e orendi per zyra te MM
19	Forcat e Luftimit	2,535	TOTALI
1	Brigada Reagimit te Shpejte ne KFB	20	Leje ndertimi Br.R.Sh.
2		40	Paisje zbulimi Br.R.Sh.
3		60	Pajisje fushore BrRSh
4		18	Pajisje te MKK per BrRSh
5		45	Pajisje te vezhgimit naten
6		69	Qender operacionale mobile per BrRSh
7		346	Blerje helikopteri
8		355	Pajisje te komunikimit taktik me radio
9		101	Paisje luftarake individuale
10		86	Nd.Linj TL-20KV Rep. Ush.1108 Zall - Herr
11		3	Studime e projektme (Art.230)
12		320	Pajisje speciale R.Komando
13		62	Ndert.kabin elek.rrjeti I jashtem
14		10	Paisje per MCU
15		Regjimenti KOMANDO ne KFB	40
16	Br.Detare ne KFB	22	Rik.Objekte ne funksion te SVD F.V. Br.D.
17	Batalioni Logjistik ne Brigaden Detare te KFB	20	Rik.rrjetet ujesjellesi e fiber optike F.J.Br.D.
18		895	Blerje anijesh patrulluese F.J.Br.D.
19		25	Studime e projektme (Art.230)
8	Arsimim Usharak	343	TOTALI
1	Komanda e Doktrines dhe Stervitjes	52	Rik.mjedise sportive KDS
2		6	Studim i poligonit Kombetar BIZE (KDS)
3		64	Ndertimi i sistemit te ngrohjes ne KDS
4		100	Qender Simulimi Konstruktiv KDS
5		25	Pajisje te sigurise KDS
6		37	Pajisje
7	Brigada e Stervitjes Bunavi ne KDS	37	Ndertim poligoni Br.S.Bunavi
8		22	Shpronese Br.S.B
1	Mbeshtetja Shendetesore	17	TOTALI
1	Spitali U.Q.U.	17	Ndertim impianti per djegie mbeturinash
9	Mbeshtetja e Luftimit	392	TOTALI
1	Brigada Ajrore ne KFB	30	Ndertim hangari mirembajtje
2		23	Rik.rrjeti ujesjellesi Farke Br.Ajrore
3		61	Rik.rrjeti inxhinierik Rinas Br.Ajrore
4		50	Pajisje identifikimi te helikoptereve
5		19	Ndertim Depo Karburanti

Plani i Integruar i Ministrisë

6		3	Ndertim godine per MNZSH
7		40	Studime per ASOC
8		110	Pajisje e sisteme speciale
9	Qendra e Radiozbulimit	55	Rik.godine Sauk
20	Mbeshtetja e Perqendruar	2,048	TOTALI
1		100	Kredi per strehim per ushtaraket F.A.
2		406	Sistemi Vezhgimit te Hapsires Detare
3		550	Pajisjet Individuale te Ushtarit
4		57	Blerje Mjete Transporti dhe Speciale
5		16	Pajisje per LaboratorinQendror te FA
6		25	Makineri e pajisje per mirembajtje helikopterash BO 105
7		38	Pajisje Harduer te teknologjise se informacionit
8		4	Sisteme Sfortuer te teknologjise se informacionit
9		18	Pajisje mbeshtetese per SNI
10		635	Blerje zjarr fikese
11	Brigada Logjistike ne K.Mb.	10	Studime e projektme (Art.230)
12		10	Rikonstrukcion Mence Kuzhine BSHP
13		12	Rikonstrukcion rrjeti elektrik BSHP
14		8	Rikonstrukcion godine SNI B.Nderlidhjes
15		19	Rik.Godine te Orkestra Frymore te U.
16	Regjimenti Mbeshtetjes ne K.Mb.	9	Pajisje per mbeshtetjen e Medias
17	Bt.Nderlidhjes ne Regj.Mb. te K.Mb.	78	Pajisje te telekomunikimit Fiks
18		11	Rikonstrukcion zyresh ISPMB
19	ISPVMb	23	Studime e projektme (Art.230) ISPVMb
20	Arkivi Ushtrise	20	Rafte kompakte
2	Bashkepunimi Civilo-Ushtarak (AL-CIMIC)	67	TOTALI
1		30	Rikonstrukcion grup depo qendrore
2	Brigada Mbojtjes Rajonale ne KFB	37	Rikonstrukcion rrjete inxhinierike
62	TOTALI FINANCIM BRENDSEHEM	5,670	TOTALI MM

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Nr	Emërtimi i Projektit	Donatori
1	Projekti 101 “Mbështetje për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm”	ITALIA
2	Projekti 107 “Mbështetje Shëndetësore”	ITALIA
3	Projekti 110 “Mbështetje Kom. Doktrinës dhe Stërvitjes”	ITALIA
4	Projekti 112 “Organizimi Logjistiko-Administrativ”	ITALIA
5	Projekti 113 “Mbështetje batalionit të Policisë Ushtarake dhe Brigadës së Mbështetjes Rajonale”	ITALIA
6	Projekti 203 “Mbështetje Njësive të Xhenios dhe EOD-së”	ITALIA
7	Projekti 210 “Mbështetje Brigadës së Reagimit të Shpejtë”	ITALIA
8	Projekti 301 “Mbështetje Njësive Detare Shqiptare dhe Shërbimit Hidrografik të Forcave Detare”	ITALIA
9	Projekti 303 “Mbështetje Rojes Bregdetare”	ITALIA
10	Projekti 401 “Kontrolli i Trafikut Ajror dhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak”	ITALIA
11	Projekti 404 “Organizimi SAR”	ITALIA
12	Projekti 408 “Mbështetje Regjimentit të Helikopterëve”, Farkë	ITALIA
13	Projekti ANO - Mbështetje Akademisë së Nënoficerëve	HOLLANDA
14	Mbështetje për modernizimin e komponentit detar (mbështetje për krijimin e qendrës së zhytësve)	HOLLANDA
15	Aktiviteti B1, mbështetje për mirëmbajtjen e pajisjeve logjistike të shëndetësisë.	HOLLANDA
16	Mbështetje për Forcat e Armatosura Shqiptare	SHBA
17	Programi “IMET (International Military Education)	SHBA
18	Programi “Marshall Center”	SHBA
19	U.S Services Academies	SHBA
20	English Language Training Program	SHBA
21	Global Peace Keeping - Operations Training Case	SHBA
22	Foreign Military Funds	SHBA
23	Projekti “Për sistemin radiondërlidhje njëkanaleshe”	SHBA
24	Mbështetje për laboratorin qendror të Forcave të Armatosura	ZVICRA
25	Mbështetje për Brigadën e Mbështetjes Rajonale	ZVICRA
26	Projekti 1.4, për ndërtimin e LAN dhe PC-s	DANIMARKA

27	Projekti 1.3, përshtatja dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe pajisjeve sipas Standarteve	DANIMARKA
28	Projekti 4.1, zhvillimi dhe implementimi i sistemit të mbështetjes logjistike sipas standardeve të NATO-s për 10 PG.	DANIMARKA
29	Mbështetje për logjistikën.	TURQIA
30	Projekti: “Zhvillimi i infrastrukturës në aerodromin e Kuçovës”	TURQIA

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

- Plotësimi i detyrimeve ligjore në hartimin e planeve në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit dhe Planit të Punës së Ministrisë së Mbrojtjes për luftën kundër korrupsionit.
- Zbatim i planit të punës në drejtim të ndërgjegjësimit të publikut për pjesëmarrje në luftën kundër korrupsionit.
- Përmirësimi i trajtimit dhe evidentimit të rasteve të denoncimeve publike.
- Organizmi i një seminari me Komandën Amerikane për Evropën dhe Qendrën Marshall për përgjegjësitë e Inspektimit të Përgjithshëm.
- Përmirësimi i planit të masave në zbatim të ligjit për ndërgjegjësim dhe informim publik.